



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 43-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30.06.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
21. Ganimete Qeriqi, anëtare
22. Alban Salihu, anëtar
23. Fitim Meziu, anëtar
24. Fadil Spahiu, anëtar
25. Fatmir Fetahu, anëtar
26. Shahadije Dragaçina, anëtare
27. Besiana Sylja, anëtare
28. Enver Kryeziu, anëtar
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Latif Ramadani, DBF
4. Elmaze Behluli, DA
5. Sead Aliu, DI
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DKA
9. Safete Amerllahu, DGJK
10. Flamur Sylejmani, DI
11. Burim Rrustemi, DSHPMSH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica- Llugiqi, DKRS
14. Shkelzen Hajdini, DSHP
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 42-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.
3. Propozim vendim për ndryshimin e emërimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Adem Gllavica”
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
5. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15nr.352/05-27004 i datës 29.05.2025 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se sot kam për ti ngritur disa pyetje që lidhen direkt me integritetin transparencën dhe përgjegjësinë institucionale të komunës tonë. Pyetjet

që cilat do ti drejtoj janë shqetësime të qytetarëve që po e humbin besimin te institucionet. Pyetja e parë a është shqyrtuar nga ekzekutivi, organet komunale apo zyra ligjore në këtë rast, për një konflikt interesi për një zyrtar të lartë që është pranuar në QPS, ku anëtarja e komisionit vlerësues ka lidhje familje vajzë të hallës dhe vajzë të dajës. Unë kam reaguar dhe kam treguar që ka shkelje, ka konflikt interesi në vije të tërthortë. Pse po ndodhin këto shkelje? Pyetja e dytë si është e mundur që nënkryetari për komunitete i është nënshtruar një konkursi publik pa dhënë dorëheqje nga pozita aktuale. Nënkryetari më datën 27.05.2025 ka hyrë në testin me shkrim për këtë pozitë ndërsa me 29.05.2025 ka qenë prezent në sallë të kuvendit si nënkryetar i komunës. Ndërsa në bazë të informatave që i kam ka dhënë dorëheqje nga pozita e nënkryetarit pasi që është pranuar në atë pozitë. Kjo nuk duhej të ndodhte në komunën e Lipjanit.

Lulzim Rrustemi, tha se kam një pyetje për drejtorinë e Urbanizmit, rruga që shkon prej Lagjes së Akllapit në drejtim të rrugës Lipjan-Banullë, te udhëkryqi në anën e majtë është ndërtuar një objekt. Dua ta di a është respektuar vija ndërtimore dhe a ka leje ai objekt.

Besiana Syla, tha se do ta ngris një çështje mungesën e dozave të serumit kundër gjarpërinjve. Kanë qarkulluar disa informacione se ka mungese serumi edhe në QKMF në Lipjan. Kush mban përgjegjësi nëse i ndodh diçka ndonjë qytetari shkak i neglizhencës. Tjetra a keni ndërmarr ndonjë iniciative tash gjatë sezonës së verës për dezinfektimin e hapësirave publike për eliminimin e mushkonjave dhe insekteve. Dhe për fund kam për ta ngritur shqetësimin për grumbullimin e mbeturinave në qytet dhe në fshatra dhe nuk po ka mbikëqyrje siç duhet duke përfshirë edhe shtegun e biçikletave.

Fitim Mëziu, tha se i kam disa pyetje lidhur me punën në QKMF-në për drejtorin, a paguhen vikendet për punëtorët shëndetësor të cilët punojnë gjatë të shtunave dhe të dielave. Pyetja tjetër pse në QKMF një nr. i mjekëve punojnë sipas nevojës, në bazë të çfarë dispozite ligjore këta mjek punojnë sipas nevojës. Tjetra në oborrin e QKMF-së është një logo ku përshkruhet emri i barnatorës qendrore, ndërsa poshtë edhe emri i shefit që punon aty. Pse duhet të jete emri i shefit në kuadër të atij institucioni pse nuk është vendosur edhe emri i drejtorit edhe i shefave dhe mjekëve të tjerë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se pak ditë na ndajnë nga 26 vjetori i çlirimit të Lipjanit e kemi parë që edhe këtë herë kemi pasur agjendë të njëjtë duke u përsëritur nga viti në vit. Mirëpo nuk duhet ti harrojmë edhe të gjallët që kanë dhënë kontribut

dhe ti nderojmë sa janë gjallë. Dhe ata janë ushtaret e UÇK-së. Unë e kam parë që shumë komuna në përvjetorin e çlirimit çdo herë ju ndajnë mirënjohje ushtarëve të UÇK-së. Pse kjo nuk po ndodh në Lipjan. Në fshatin Sllovi janë shtruar shumica e rrugicave mirëpo ka mbet pa u asfaltuar rrugica te lagjja e Belincve. Çështja tjetër, ka filluar trajtimi dhe kujdesja ndaj qenve endacak mirëpo me sa po e shoh, deri tani nuk duket që po ka lëvizje si projekt. Sa po zbatohet ky projekt? Mbeturinat në rrugën “Isa Olluri” nuk po mblidhen mbeturinat jashtë kontinjerve. Gjendja e tyre është e tmerrshme. Është një kërkesë prej banorëve të fshatit Konjuh për vendosjen e shenjave për kufizimin e shpejtësisë.

Ardit Cani, tha se kam një kërkesë të banorëve të lagjes “Pojata” në fshatin Shalë në të cilën kanë problem që disa vite dhe nuk është lidhur kanalizimi i kësaj lagje me kanalizimin kryesor. Tjetra a është ndërmarr ndonjë hap për depononi ilegale nëpër fshatra dhe a është ndërmarr ndonjë veprim për pastrimin e tyre.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se kam dy çështje për ti ngritur e para ka të bëjë me kanalizimin në fshatin Janjevë te rruga “ Bajram Gajtani” dhe erërat po kundërmojnë pasi që për ata banorë është bërë problematike e madhe. Tjetra Rruga që lidh me rrugën “Isa Olluri” me rrugën “Zylfie Gashi” ende nuk ka përfunduar kur pritet të asfaltohet ajo rrugicë.

Alban Salihu, tha çështja e parë që do ta ngris ka të bëjë me një klub të futbollit që është themeluar viteve të fundit nuk është që po marrin mbështetje nga institucionet komunale dhe nuk po ju lejohet as shfrytëzimi i stadiumit të qytetit. Kërkoj nga organet komunale që të ju lejohet shfrytëzimi i stadiumit të qytetit pasi që stadiumi është i të gjithëve. Po ashtu kam edhe një kërkesë nga qytetarët për rrugën “Sadik Shala” e cila nuk po mirëmbahet. Po ashtu kam vizituar disa fshatra dhe në shumicën e fshatrave mungon ndriçimi publik.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju kisha lutur që ta respektoni Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Rinor Murati, tha se kam një pyetje, për vitin e ardhshëm shkollor a do të kemi sistemim të nxënësve të shkollave të qytetit. Dhe pyetja e dytë, për mirëmbajtjen e ndriçimit publik a keni ndonjë informatë nga OSHP-ja.

Albiona Tasholli, tha se kam pyetje për drejtorin e arsimit, si ka shkuar procesi i mbajtjes së testit të maturës dhe a ka pasur ndonjë problem gjatë mbajtës së provimit? Si e vlerësoni përfundimin e vitit shkollor?

Fadil Spahiu, tha se kam dy çështje për ti ngritur e para është lidhur me energjinë elektrike te parkingu nëntokësor, aty shpesh po ka mungese të energjisë elektrike. E dyta një shtyllë e ndriçimit publik është rrëzuar në fshatin Smallushë , kërkoj që të njoftohet kompania për rregullimin e saj.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se aty ku ka dyshime për konflikt interesi le ta hulumtojnë, sepse nuk ka asgjë për tu fshehur, sepse zyrtarët e administratës duhet të kenë kujdes nëse ka konflikt interesi. Kjo nuk bëhet e qëllimshme por është spontane. Mund të ketë ndonjë lagje që ka probleme me kanalizim mirë po kjo mund të ndodh për shkak të pozitës gjeografike apo ose defekteve të ndryshme që kanë mundur të ndodhin gjatë projektimit. Nevoja për një efikasitet më të madh për mbledhje të mbeturinave ka nevojë mirëpo ata kanë telashe me funksionim, por ju e dini qe mbledhjen e kaluar kemi marrur një vendim për këtë kompani për derivate të naftës. Është mirë që mbeturinat jashtë shportave mos te hudhen. Tjetra ju e dini që nuk është anashkaluar asnjë fshat për probleme politike, ka mundur të anashkalohej për ndonjë problem pronësor, por në fshatrat i kemi përfshirë të gjitha. Projekti për qentë endacak është në proces, nuk është hiç e lehtë sepse organizatat që e monitorojnë kërkojnë raport dhe proces për secilin qen. Dita e çlirimit ka ekzistuar që disa vite njëjtë. Deponitë ilegale janë mbledh shënimet se ku ka dhe sasia e tyre, dhe muajin tjetër do të fillohet. Stadiumin e qytetit kuvendi ja ka dhënë KF Ulpianës. Mirëmbajtja e ndriçimit publik ka pakëz telashe por lënda është në OSHP ende. Risistemimi i nxënësve do te ndodh në shtator, shkolla e re do të përdoret për nxënësit e shkollës Ulpiana. Parkingu i komunës nuk është pranuar ende teknikisht dhe mund të ketë probleme me ndriçim herë pas herë. Janë duke u bërë disa punë si sistemi i sinjalizimit, kamerave ndriçimit dhe disa tjera dhe do të lidhen edhe me rrymë.

Shkelzen Hajdini, tha se në QKMF në Lipjan nuk ka mungesë të serumit kundër kafshimit te gjarpërinjve dhe ne kemi sasi të mjaftueshme. Disa mjeke janë sipas nevojë për shkak te kohës se pushimeve dhe ngarkesës në punë për tu mbuluar çdo pjesë. Paguheni dhe për vikende sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket barnatores nuk e di për reklamën.

Imri Semetishti, tha sa i përket pyetjes lidhur me lejen e ndërtimit në rrugën “Bajram Gashi” te kryqëzimi, aty është dhënë një leje në bazë të kriterëve të përcaktuara me hartën zonale të komunës. A është gjendja ndryshe në teren nuk e di.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 42-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 42-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 42-të e Kuvendit, pas votimit u konstatua se Kuvendi me, 20 vota për , aprovoi Ekstraktin e 42-të të Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Fitim Mëziu, tha se kam një pyetje a ekziston ndonjë kod i miratuar për pagimin e kujdestarive dhe vikendeve në kuadër të KAB-it. Nëse nuk ka një kod të tillë atëherë kuvendi është mirë të bëjë një kërkesë për zgjidhje për pagesën e tyre në ministri nëse ka vullnet kuptohet.

Shahadije Dragaçina-Bikliqi, tha se te KAB-i, do të ndalem te mungesa e ujit, e kam parë që janë disa projekte në disa fshatra dhe kjo është e mirë që po bëhet. Por ajo që nuk e pash dhe që po mungon është çështja e ujit të pijes në Janjevë. Për vite të tëra banorët e Janjevës vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë të ujit të pijës dhe kjo është bërë e papërballueshme për ta. Unë e kam një pyetje a e keni ndërmend të bëni ndonjë intervenim që të bëni një zgjidhje për çështjen e ujit në Janjevë.

Lulzim Rrustemi, tha se e kemi diskutimin KAB-in, 2026-2028 drafti i parë, aspekti ligjor është shumë mirë ,debatet janë mbajtur aq sa janë mbajtur, kërkesat janë reale dhe të bazuara në fakte. Por në këtë kornizë ka edhe mungesa për të cilat ne kemi vërejtje serioze. Buxheti i ndarë në kategori të ndryshme, por një shumë e vogël e mjeteve është ndarë për arsim. Ne i kemi disa vërejtje esenciale siç është rasti me asfaltimin e rrugicave në disa fshatra faza e tretë mijëra euro. Po ashtu edhe aneks rrjeti në disa vende dhe këtë duke i përfshirë ka disa fshatra dhe duke mos u specifikuar se cilat rrugë me çfarë çmimi. Këto mjete nuk po ndahen në mënyre racionale, asnjë projekt për ujërat e zeza, mungon asfaltimi i rrugës Topliqan- Kojksë,

shkollat e vjetra Dobrajë dhe Banullë prapë nuk i kemi. E si grup i PDK-së do të ju japin kohë për shtator kemi kohë kemi debatet për te përmirësuar këto, ne si grup abstenojmë tani për shkak të vërejtjeve që i kemi.

Egzona Bytyqi, tha se para vetes e kemi njërin ndër dokumentet më të rëndësishme që e ka komuna jonë, unë meqë vij nga sfera e shëndetësisë fokusi im është aty dhe në buxhet janë dy projekte që unë edhe në aspektin moral dhe aspektin profesional nuk mundem të votoj kundër. Unë kam propozuar që në kuadër të analizave të fundit edhe gjëndrat tiroide dhe pajisja me ultrazë në QKMF. Unë pasi që jemi në këtë fazë kam edhe dy propozime e para propozoj që të ndahet buxhet për edukim dhe promovim shëndetësor. Në anën tjetër te inkorporohen edhe defibrilatorët jo vetëm për klube sportive por edhe ne QMF dhe AMF.

Rinor Murati, tha se unë disa prej propozimeve që i kam për buxhet i kam adresuar ne dëgjimet buxhetore. Por një ndër kritikën është edhe pjesëmarrja e ulët në dëgjime buxhetore dhe ne anëtarët e kuvendit nuk mund të bëjmë kritika kur edhe vete nuk marrim pjesë në dëgjime buxhetore ku në dëgjimin e fundit kemi qenë vetëm 3 anëtar.

Alban Salihu, tha se të gjitha buxhetet nëse e shikon edhe vitet e kaluara nuk dallon fare vetëm në numra, ka mungesë të kreativitetit i njëjti shtrimi i rrugicave asfaltim ndriçim publik. Ndërtimi i tregut të gjelbërt është përfunduar më herët pse të ndahen prapë mjete, ndarja e lumenjëve janë pastruar njëherë prapë njëjtë ndahen mjete. Pra ky është një buxhet jo kreativ dhe aspak nuk i përmbush nevojat e qytetarëve.

Fitim Mëziu, tha se unë do te votoj pro këtij buxheti, pasi që në kuadër të saj është edhe objekti i ri i QKMF-së, dhe jam shumë i kënaqur që kërkesa ime është aprovuar që të këtë një objekt të tillë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se KAB-i nuk është përfundimtar dhe propozimet vërejtet do të mundohen të akomodohen në kuadër të buxhetit. Gjatë seancave të më hershme në kuvend kam marr prej juve kërkesa të ndryshme për asfaltimin e rrugicave në këtë lagje ne atë lagje, ose kanalizim ose ndonjë kërkesë tjetër. Kjo ka qenë si kërkesë që ka ardh nga ana juaj. Te shëndetësia edukimi dhe promovimi mund të hyjnë në kuadër të mallrave dhe shërbimeve ndërsa kjo defibrilatori mund të hyjë. Buxheti ka rritje të krahasohet me vitet e kaluar thuaj në çdo aspekt. Kemi nevojë të rrisim buxhetin te mirëmbajtja. Çdo projekt që e kemi bërë kanë fol kanë diskutuar mirëpo ne punojmë për të mirën e qytetarëve edhe jo kujt i pëlqen ose jo.

Çështja e ujit në Janjevë kemi investuar te gypi i ujit të pijës në rrjetin e ujësjellësit dhe jemi të gatshëm çdo gjë me investuar.

Shahadije Bikliqi-Dragaqana, tha se ne si grup i VV kemi me propozuar qe me nda një pronë me bashkëpunim me ujësjellësin dhe ministrinë përgjegjëse dhe të hapen bunarët në mënyrë që të ju bëhet qytetarëve zgjidhje.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se hyni verifikoni dhe vërtetoni ne buxhetin e vitit 2022 në pronën e pulave në Janjevë dhe kemi hap 5 puse po ashtu edhe 3 në Lipjan. Ne kemi investuar në ujësjellës por ne nuk e menaxhojmë me ujësjellësin. Dhe unë sot jam i gatshëm të investoj prapë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me tabelën shtesë të cilën e keni pranuar si aneks shtesë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 4 kundër dhe 6 abstenime aprovoi propozimin

III

Propozim vendim për ndryshimin e emërimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Adem Gllavica”

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se kam një pyetje se cilat janë përparësitë nga kalimi i emërimit që ka qenë ne këtë tani.

Arsim Jashari, tha se ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Rasim Hasani, tha se nuk ka ndonjë ndryshim te madh janë do ndryshime të vogla.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi propozimin për shtyrje të kësaj pike.

IV

Propozim vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se drejtorët i zgjedh ligji dhe komisioni të cilin e cakton kryetari. Ne i kemi mbështet çdo herë këto propozime si grup por do të abstenojmë, për arsye se nuk është dashtë me ardh fare në kuvend ky vendim, e dyta, fillimisht hapet konkursi deri sa të shkon ne ministri i keni bo grumbull dhe kjo ka mu kthye prapë. Ne do të abstenojmë.

Alban Salihu, tha se edhe për nga niveli i drejtorëve të shkollave shihet që ata i zgjedh Imri Ahmeti ata sillen si zyrtar te LDK-së, e jo si drejtor të shkollave. Për këtë arsye ne do të votojmë kundër.

Albiona Tasholli, tha se në emër të grupit te LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

Rasim Hasani, tha se ligji e thotë që drejtorët e shkollave i zgjedh kryetari i komunës. Sipas zyrës ligjore një herë duhet me u bërë komisioni pastaj me u shpall konkursi.

Alban Salihu, tha se me cilin ligj i zgjedh drejtoret e shkollave kryetari i komunes.

Meqë diskutime të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 3 kundër, 6 abstenime aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15nr.352/05-27004 i datës 29.05.2025 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ky vendim i MAPL-se, nga ana e ministrisë do me thënë që ata punën e deponise ilegale nuk e kanë në harrese dhe është kushtëzuar. Me që jemi ne të drejtën tonë me u shtjeru te gjithë mekanizmat qe kjo me ardhe prapë në kuvend.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ne sigurisht qe do të shterojmë te gjithë mekanizmat dhe prapë do ta sjellim në kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, dhe 2 abstenime aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi